

## **AKTI I THEMELIMIT**

### **DHE**

### **STATUTI**

## **I SHOQËRISË AKSIONARE**

## **AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE**

Akti i themelimi dhe Statuti hartohen bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjin nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe në zbatim të vendimit nr. 37, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a”.

### **KREU I**

## **THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

### **Neni 1**

#### **Data e themelimit, emri dhe themeluesi**

1. Sot, më 25.2.2026, në Tiranë, themelohet shoqëria aksionare shtetërore me emrin “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve”, me emrin e shkurtuar “AKEM”, këtu e në vijim “Shoqëria”.
2. Shoqëria themelohet si person juridik shqiptar që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 21.1.2026, “Për organizimin e brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a.”.
3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin, si aksionar i vetëm/pronar i 100% të aksioneve, është ministria përgjegjëse për mjedisin.
4. Aksionari i shoqërisë gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributit në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar nga aksionet.
5. Shoqëria, për qëllime të promovimit, komunikimit publik, marketingut, apo zhvillimit të platformave digjitale, do të përdorë emërtimin tregtar “Operatori i Trajtimit të Mbetjeve” dhe në formën e shkurtuar “OTM” në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 44, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe parashikimet e vendimit nr. 537, datë 1.8.2007 Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare”.
6. Shoqëria ka stemën, logon dhe vulën zyrtare që miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Këshillit Mbikëqyrës.

## **Neni 2** **Objekti**

### 1. Shoqëria ka si objekt kryesor veprimtarie:

- a) Bashkërendimin me institucionet e administratës publike, në nivel qendror e vendor, partnerët ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, për planifikimin territorial të infrastrukturës së mbetjeve dhe funksionimin e tyre në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi;
  - b) ndërtimin, zhvillimin, koordinimin dhe administrimin e infrastrukturës së rritit kombëtar të impianteve të trajtimit (rikuperimit dhe asgjësimit) të mbetjeve;
  - c) projektimin dhe zbatimin e projekteve për ngritjen e infrastrukturës fundore të menaxhimit të mbetjeve;
  - ç) ofrimin, kundrejt pagesës, të shërbimit të trajtimit fundor të mbetjeve dhe çdo shërbim tjetër, në përputhje me qëllimin e krijimit të saj;
  - d) monitorimin e zbatimit të planeve dhe programeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel qendror dhe vendor;
  - dh) nxitjen dhe promovimin e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve, për realizimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe rikuperimin e tyre në shkallë të gjerë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet veprimtarive të edukimit mjedisor;
  - e) monitorimin e zbatimit të detyrimeve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga bashkitë dhe të objektivave të tjerë të menaxhimit të integruar të mbetjeve;
  - ë) koordinimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore të iniciativave dhe veprimeve, përfshi ato ekonomike, për të favorizuar riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve, nëpërmjet nxitjes dhe promovimit të tregut të produkteve të rikuperuara dhe përdorimin e tyre nga administrata publike, subjektet tregtare dhe konsumatorët;
  - f) bashkëpunimi me entitete publike apo organizma ndërkombëtarë me qëllim marrjen e ndihmës, asistencës teknike dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e objektit të aktivitetit.
  - g) brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tregtare a financiare që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj, si më sipër.
2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, shoqëria do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet me objektin e veprimtarisë së saj. Për përmbushjen e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a mund të krijojë shoqëri, të hapë degë dhe zyra përfaqësimi sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

## **Neni 3** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve” sh.a, është e pacaktuar.

## **Neni 4**

## **Selia**

Selia e Shoqërisë “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve” sh.a ndodhet në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, Tiranë.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

1. Kapitali i Shoqërisë është 100% shtetëror. Shteti shqiptar është aksionar i vetëm i Shoqërisë dhe përfaqësohet nga ministria përgjegjëse për mjedisin.
2. Kapitali themeltar i Shoqërisë është në shumën 20.000.000 (*njëzet milionë*) lekë dhe transferohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Kapitali themeltar është i ndarë në 100 (*njëqind*) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 200.000 (*dyqind mijë*) lekë secili, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë të zotëruara nga aksionari i vetëm.

### **Neni 6 Zmadhimi i kapitalit themeltar**

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet, duke emetuar aksione rishtazi përkundrejt kontributeve të reja, të nënshkruara vetëm nga aksionari i vetëm.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet edhe nëpërmjet aktiveve të Shoqërisë. Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, aksionari i vetëm mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë, rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
3. Shoqëria do të njoftojë QKB-në për vendimin e miratuar lidhur me zmadhimin e kapitalit, në përputhje me afatet e parashikuara në ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Zmadhimi i kapitalit do të hyjë në fuqi në datën e regjistrimit të realizimit pranë QKB-së.

### **Neni 7 Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të aksionarit të vetëm, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 145, të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

3. Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

### **KREU III**

#### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

##### **Neni 8**

##### **Organet e Shoqërisë**

1. Organet drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., janë:
  - a) Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Këshilli Mbikëqyrës;
  - c) Administratori.

##### **Neni 9**

##### **Asambleja e Përgjithshme**

1. Ministri përgjegjës për mjedisin, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionarit të vetëm, ushtron të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të parashikuara nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, që nuk janë shprehur në këtë statut.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
  - a) miratimin e statutit të shoqërisë dhe ndryshimeve të tij, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës;
  - b) përcaktimin e politikave të përgjithshme tregtare; përfshirë edhe përcaktimin e tarifave/çmimeve të shërbimeve të ofruara nga shoqëria;
  - c) emërimin, lirim dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
  - ç) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - dh) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - e) miratimin e planeve dhe strategjisë për zhvillimin e Shoqërisë, në përputhje me dokumentet strategjike shtetërore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve;
  - ë) miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - g) miratimin e blerjes, pjestimit, anulimit të aksioneve si dhe riorganizimin, prishjen apo/ose likuidimin e Shoqërisë;
  - gj) miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
  - h) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
  - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - j) miratimin e çdo garancie, pengu, barre ose të drejte të ngjashme që do të jepet në favor të palëve të treta nga ana e Shoqërisë;

- k) miratimin e marrjes përsipër të detyrimeve për Shoqërinë, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
  - l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare që nuk janë përmëndur në këtë statut.
3. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
  4. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Vendimet e paregjistruara janë absolutisht të pavlefshme.

### **Neni 10**

#### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara në nenin 136, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në statutin e Shoqërisë dhe sa herë është e nevojshme në interes të Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori, dhe në rastet e parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose nga aksionari.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi/thirrja e mbledhjes duhet të përmbajë emrin e Shoqërisë, selinë e regjistruar, rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes, arsyet dhe çështjet për diskutim. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të Shoqërisë.
4. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit për të miratuar pasqyrat financiare/llogaritë vjetore, brenda 6 muajve nga mbarimi i vitit ushtrimor, si dhe për të ushtruar çdo kompetencë që i jep ligji.
5. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme është e detyrueshme në rastin e ngjarjeve të parashikuara nga neni 136, i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### **Neni 11**

#### **Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Mbledhja mbahet në ambientet e selisë së Shoqërisë ose edhe në një vend tjetër për të cilin është rënë dakord. Nëse është e nevojshme, mbledhja mbahet edhe nëpërmjet telekonferencës apo mjeteve të ngjashme të komunikimit.
2. Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kanë të drejtën të marrin pjesë dhe të marrin fjalën edhe administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.
3. Vendimet në mbledhjet e asamblesë merren nga aksionari i vetëm i Shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë:
  - a) 2 (dy) anëtarë, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;
  - b) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
  - c) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor;
  - ç) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga asambleja e përgjithshme, pas propozimit nga institucionet përkatëse, sipas parashikimeve të pikës 7, të vendimit nr. 37, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a”, me afat 3 vjeçar, me të drejtë riemërimi.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjedhin ndërmjet tyre një kryetar dhe një nënkryetar. Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t’i kryer ato personalisht. Me miratimin e asamblesë së përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës cakton ose emëron një sekretar që mund të jetë edhe jashtë anëtarësisë.
4. Anëtarë të parë të Këshillit Mbikëqyrës emërohen personat e mëposhtëm:
  - a) *Athanas Karaja*, i datëlindjes 22.03.1971, numër personal H10322167B, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për mjedisin;
  - b) *Elvana Ramaj*, e datëlindjes 28.04.1969, numër personal G95428189M, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për mjedisin;
  - c) *Ina Kruja*, e datëlindjes 21.06.1985, numër personal I55621045H, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;
  - d) *Silvana Merdani*, e datëlindjes 22.07.1994, numër personal J457220540, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor;
  - e) *Albin Gega*, i datëlindjes 01.07.1977, numër personal H70701274S, si përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

### Neni 13

#### Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në shkronjat “b” deri në “g” dhe “i” të pikës 1, dhe pikës 2, të nenit 154, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ka këto kompetenca:
  - a) propozon për miratim në Asamblenë e Përgjithshme statutin e Shoqërisë dhe ndryshimet në të;
  - b) propozon Asamblesë së Përgjithshme politikat tregtare, planet dhe strategjinë zhvillimit të Shoqërisë;
  - c) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Shoqërisë;
  - ç) të përgatisë me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t’i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t’u

marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

- d) propozon metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve të ofruara nga shoqëria;
  - dh) të shqyrtojë dhe kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
  - e) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
  - ë) të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo Statutit, kryhen me saktësi nga shoqëria;
  - f) të miratojë e nëshkruajë dokumentat e përcaktuara në shkronjën “ë” të kësaj pike, si dhe të paraqesë raportin përkatës sipas parashikimeve të shkronjës “e” te pikës 1 të nenit 154, të ligjit nr. 9901/2008;
  - g) të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, si dhe raporti i auditimit drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t’u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit. Raporti i parashikuar në shkronjën “ë” të këtij neni të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
  - gj) të miratojë planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;
  - h) miraton projektet e investimit;
  - i) krijon komitete të posaçme të përbëra nga anëtarët e vet, lidhur me mbikqyrjen e zbatimit të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël;
  - j) miraton strukturën dhe organikën e Shoqërisë;
  - k) miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë si dhe të funksionimit të këshillit;
  - l) miraton rregullat për mënyrën, rastet dhe shpërblimin e pajtimit të këshilltarëve të jashtëm ose ndihmës të jashtëm me kërkesë të administratorit;
  - ll) përcakton dhe miraton pagat dhe shpërblimet për administratën e shoqërisë dhe organet e saj;
  - m) detyra të tjera të parashikuara nga ligji nr. 9901/2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe ligji nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Shoqërinë.

#### **Neni 14**

#### **Kriteret e emërimit dhe shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

1. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës duhet të plotësojë këto kriteret:
  - a) të jetë shtetas shqiptar;
  - b) të ketë arsim të lartë të nivelit të dytë;

- c) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 7 vjet në sektorin publik ose privat, nga të cilët jo më pak se 5 vjet në pozicione drejtuese/menaxheriale;
  - ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - d) të mos kenë interesa të drejtpërdrejta ose tërthorta që mund të krijojnë konflikt interesi me detyrat mbikëqyrëse;
  - dh) të mos marrë pjesë në më shumë se dy këshilla mbikëqyrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.
2. Me propozim të administratorit dhe miratim të Asamblesë së Përgjithshme, anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës u caktohen shpërblime suplementare në formën e pagesave të veçanta për angazhime specifike përtej detyrave funksionale dhe shpërblime të posaçme, bazuar në performancën dhe arritjen e rezultateve të larta të Shoqërisë.
  3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163, të ligjit 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Për shkeljet e kryera nga administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 163, të ligjit datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë asamblenë e përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje, apo kur nuk i kanë zbuluar ngaqë funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.

#### **Neni 15**

#### **Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet rregullisht të paktën 4 herë në vit, si dhe sa herë e kërkon interesi i Shoqërisë.
2. Mbledhja mbahet në ambientet e selisë së Shoqërisë ose edhe në një vend tjetër për të cilin është rënë dakord. Nëse një ose më shumë anëtarë nuk janë në gjendje të marrin pjesë në një takim personalisht, Këshilli Mbikëqyrës do të lehtësojë lidhjet me mjete të tjera të mundshme, përfshirë telekonferencën ose mjete të ngjashme të komunikimit, me kusht që anëtarët e tjerë të kenë mundësi të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara. Në këtë rast, mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet drejtuesi i mbledhjes.
3. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet në seancë të veçantë me kërkesë të kryetarit, nënkryetarit apo dy prej anëtarëve të tij, me kërkesë të aksionarit ose administratorit.
4. Kryetari drejton mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës. Në rast se kryetari është në pamundësi për të drejtuar mbledhjen personalisht, nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit.
5. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

6. Vendimet e këshillit të administrimit mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.
7. Përjashtimet nga e drejta e votës, sipas nenit 148, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen edhe për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

#### **Neni 16**

##### **Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshillit Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve të mbledhjeve. Procesverbalet depozitohen në selinë e Shoqërisë.
2. Këshilli Mbikëqyrës ngarkon sekretarin si personi përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve.
3. Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

#### **Neni 17**

##### **Largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

1. Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës humbet cilësinë e anëtarit nëse:
  - a) Jep dorëheqjen ose shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Ndodhet në kushtet e parashikuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 167, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
  - c) Bëhet i paafte fizikisht ose juridikisht për të përmbushur detyrën;
  - ç) Institucioni që përfaqëson, propozon lirim;
  - d) Ka munguar për më shumë se 2 mbledhje radhazi pa konfirmimin e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës. Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra;
  - dh) Kryen shkelje të rënda të detyrimeve ndaj shoqërisë.
2. Anëtar i shkarkuar/ i larguar zëvendësohet nga një anëtar i ri me të njëjtat kushte, sipas parashikimeve të këtij Statuti për emërimin e tyre.

#### **Neni 18**

##### **Administratori**

1. Administratori është organi ekzekutiv që drejton veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me palët e treta. Administratori gëzon kompetenca të plota për të vepruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji, ky Statut

dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit dhe ose Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë.

2. Administratori emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
3. Administratori emërohet për një afat 3 vjeçar me të drejtë riemërimi.
4. Kriteret për emërimin, lirimin dhe shkarkimin e administratorit janë parashikuar në nenin 9, të vendimit nr. 37, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave "Për organizimin e brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a".
5. Administratori ushtron kompetencat e përcaktuara në këtë Statut, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjit nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive me kapital shtetëror.
6. Kompetencat kryesore të Administratorit janë si më poshtë:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare, financiare dhe administrative të Shoqërisë;
  - b) të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me palët e treta;
  - c) të kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt, në përputhje me ligjin, të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) të përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore (dhe, nëse aplikohet, pasqyrat e konsoliduara) dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe t'ia paraqesë ato Këshillit Mbikëqyrës për shqyrtim e miratim, së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimit, për tu paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
  - d) të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës buxhetin vjetor të Shoqërisë;
  - dh) kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve ligjore;
  - e) raporton përpara Këshillit Mbikëqyrës, një herë në tre muaj, për zbatimin e politikave dhe veprimtarinë e Shoqërisë;
  - ë) të hartojë planin e biznesit të Shoqërisë dhe t'ia paraqesë për miratim në Këshillin Mbikëqyrës;
  - f) harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Shoqërisë, të cilat miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës;
  - g) të sigurojë bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së Shoqërisë;
  - gj) të nxjerrë urdhra dhe udhëzime të brendshme për menaxhimin administrativ e financiar të Shoqërisë;
  - h) të organizojë e bashkërendojë punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të Shoqërisë;

- i) të krijojë dhe zbatojë një sistem të brendshëm monitorimi dhe sinjalizimi, me qëllim identifikimin e rrethanave që mund të kërcënojnë vijimësinë e veprimtarisë së Shoqërisë;
  - j) i paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit Mbikëqyrës, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet;
  - k) siguron zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës
  - l) të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të organeve drejtuese të Shoqërisë sa herë që interesat e Shoqërisë e kërkojnë;
  - ll) të propozojë krijimin e shoqërive, hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë;
  - m) të negociojë dhe nënshkruan kontrata dhe marrëveshje bashkëpunimi sipas kompetencave të parashikuara në pikën 12, të vendimit nr. 37, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a.
  - n) kryen detyra të tjera, të papërmendura në këtë statut dhe të parashikuara në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
7. Administratori mund të delegojë ushtrimin e një ose më shumë prej kompetencave të tij tek persona të tjerë, brenda strukturës organizative të Shoqërisë. Akti i miratimit përcakton detyrën dhe fushën e kompetencës që delegohet, kufijtë e autorizimit, kohëzgjatjen e delegimit dhe përgjegjësitë përkatëse të personit të autorizuar.
8. Administratori nuk mund të delegojë kompetenca që ligji ia ka ngarkuar ekskluzivisht atij, që lidhen me marrjen e vendimeve strategjike apo miratimin e pasqyrave financiar, emërime, shpërndarje fitimi. Çdo delegim që bie ndesh me ligjin, këtë statut ose me vendimet e organeve të Shoqërisë, është i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekte juridike për shoqërinë dhe personat e tretë.
9. Administratori i parë i Shoqërisë caktohet z. Ersi Sulejmani, i datëlindjes 29.7.1980, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I05729105G.

### **Neni 19**

#### **Eksperti kontabël i autorizuar**

1. Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, për një periudhë 1 (një) vjeçare dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron si ekspert kontabël të parë z. *Ares Filto*, i pajisur me licencë nr. 469, datë 05.03.2021, NIPT: K81401002H.

### **Neni 20**

#### **Ushtrimi financiar**

1. Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.
2. Përfundimisht, ushtrimi i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon në 31 dhjetor.

## **KREU IV**

### **DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

#### **Neni 21**

##### **Inventari – llogari vjetore**

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbylljen e ushtrimit, administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar. Administratori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e Shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

#### **Neni 22**

##### **Ndarja e dividendit**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve, në përputhje me dispozitat e aplikueshme ligjore në fuqi.
2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, pasi të jenë mbuluar të gjitha humbjet e mbartura (nëse ka) shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që fitimet të ri investohen ose të destinohen në një fond special rezervë apo të vendosë një rritje kapitali, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe me politikën për dividendët.

#### **Neni 23**

##### **Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar**

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë, fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

## **KREU V**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 24**

##### **Legjislacioni i zbatueshëm**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe vendimit nr. 37, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, sh.a” dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor specifik në Republikën e Shqipërisë.
3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë, me vlerë të njëjtë ligjore, njeri prej të cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 26**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**AKSIONARI I VETËM**  
**THEMELUES I SHOQËRISË**

**Sofjan JAUPAJ**  
**MINISTËR I MJEDISIT**

